

Në fakt, e mora fjalën më shumë si një reagim ose më saktë si një detyrim për të reaguar pas një retorike, të cilën, për fat të keq, e shoh dhe e dëgjoj edhe nga përfaqësues të rinj të këtij parlamenti, por që është një avaz i vjetër. Unë mendoj se të gjithë bashkë duhet të bëjmë përpjekje për të hequr dorë nga ky avaz. Nuk mund të bëhet politikë dhe të abuzohet me viktimat, aq më tepër të bëjmë këtu prokurorin, gjyqtarin, hetuesin, policin, gjë të cilën as unë, që jam ministër i Brendshëm, nuk e marr dot përsipër. Rasti në fjalë, këtu gjej mundësinë dhe rastin t'i shpreh gjithë ngushëllimet e mia për atë ngjarje fatkeqe familjes Meta, është ndër rastet më të pastra sa i takon hetimit penal, procedural në lidhje me ngjarjen. Jo vetëm kaq, por i kemi shkuar deri në fund së bashku me Agjencinë përkatëse për Mbikëqyrjen Policore, për të nxjerrë përgjegjësitë që ka pasur trupa e Policisë së Shtetit në komisariatit e Kavajës deri te neglizhencat që ata kanë bërë, gjë që ka sjellë më pas atë ngjarje fatale. Nuk ka asnjë aludim apo rrethanë periferike që të hedhë dyshime për ngjarjen as nga prokurori, as nga hetuesit, as nga mjekët ligjorë, madje, meqë përmendët edhe Avokatin e Popullit, për rastësi kanë qenë edhe dy përfaqësues të Avokatit të Popullit, sepse kanë qenë për inspektimin e dhomave të ndalimit në komisariatit e Kavajës.

Ju ftoj ta lexoni raportin e Avokatit të Popullit në lidhje me këtë gjë, ku thuhej se ato dhoma janë plotësisht në përputhje me standardet ligjore. E nderuar deputete, Sinqerisht, ju bëj thirrje, jo vetëm juve, por të gjithëve bashkë të përpiqemi, sepse nuk është e lehtë të largohemi nga kjo mënyrë e të bërit politikë, nga ky diskurs politik, nga kjo retorikë politike, nga mënyra se si jemi mësuar gjatë këtyre 30 vjetëve për të bërë politikë, sepse nuk i shërben Shqipërisë një gjë e tillë. Unë i ftoj të gjithë deputetët që, pasi të mbarojnë hetimet dhe pasi gjykata të shprehet, të bëjnë edhe hetim parlamentar, nëse nuk binden që ajo ngjarje nuk ka të bëjë fare me asnjë nga aludimet që ju bëni për këtë gjë. Mua më vjen sinqerisht shumë keq që ju aludoni për gjëra që nuk qëndrojnë, në fakt, akuzoni shumë rëndë pjesë dhe struktura të policisë së Kavajës, sikur ata janë kriminelët dhe vrasësit.

Ta lëmë pas këtë retorikë të vjetër, duke ju ftuar, madje ju si përfaqësuese relativisht e re e këtij parlamenti dhe e kësaj force politike, të jeni tërësisht në pararojë të shpëputjes nga kjo retorikë. Faktet janë të plota, është ekspertiza e mjekëve ligjorë, janë dy mjekë ligjorë, që kanë bërë ekspertizën, është edhe i gjithë hetimi i bërë nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, që ka çuar para përgjegjësisë tre punonjës policie për neglizhencë, fatkeqe për të ndjerin Meta. Dosja është e plotë dhe e ka në dorë prokurori. Ajo është tërësisht e zbardhur. Është filmuar çdo sekuençë, që nga momenti kur i ndjeri është ndaluar nga policia, i cili është ndaluar për shkak se ka pasur një vendim gjyqate për të vendosur një masë sigurie për këtë çështje, si dhe një urdhër të prokurorit për ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Ka një procesverbal, ku cilësohet ndalimi dhe shoqërimi i të ndjerit. Çdo gjë është e filmuar që nga hyrja në komisariat dhe derisa ai është larguar drejt morgut. Çdo filmim është përshkruar edhe te raporti i Avokatit të Popullit. Ju ftoj t'i shihni të gjitha! Faleminderit!